

Data: 12.11.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje karburanti” ndarë në 3 (tre) lote si më poshtë:

Loti 1 “Furnizim me lëndë djegëse diesel (Gazoil)”

Loti 2 “Furnizim me lëndë djegëse për automjete benzine pa plumb”

Loti 3 “Lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN(Mishelë)”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP) :

Karburante 09100000-0

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës 499,082,469 (katërqind e nëntëdhjetë e nëntë milion e tetëdhjetë e dy mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH ose 5,081,789 (pesë milion e tetëdhjetë e një mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) Euro pa TVSH.

Loti 1 : “Furnizim me lëndë djegëse diesel (Gazoil)”, me fond limit 412,971,041 (katërqind e dymbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e një mijë e dyzet e një) lekë pa TVSH ose 4,204,980 (katër milion e dyqind e katër mijë e nëntëqind e tetëdhjetë) Euro pa TVSH

Loti 2 “Furnizim me lëndë djegëse për automjete benzine pa plumb”, me fond limit 30.090.765 (tridhjetë milion e nëntëdhjetë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH ose 306,392 (treqind e gjashtë mijë e treqind e nëntëdhjetë e dy) euro pa TVSH

Loti 3 “Lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN(Mishelë)” me fond limit 56,020,663 (pesëdhjetë e gjashtë milion e njëzet mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH ose 570,417 (pesëqind e shtatëdhjetë mijë e katërqind e shtatëmbëdhjetë) Euro pa TVSH

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 12.11.2024 është 98.21(nëntëdhjetë e tetë pikë njëzet e një).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik”, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 7

Loti 1 “Furnizim me lëndë djegëse diesel (Gazoil)”

Kriteret e Përgjithshme të Pranimiit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetimin për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata*”. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se “*Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*”.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të 3(tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 43, pika 4 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja

e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e karburanteve në pronësi ose me qera ku minimumi duhet të ketë stacione të tregtimit me pakice të karburanteve:

- në Bashkinë Tiranë të ketë të paktën 3 (tre) stacione të tregtimit me pakice të karburanteve sipas Tabelës nr.1;
- në Bashkitë/Njësitë Administrative sipas tabelës nr 2 të ketë të paktën 5 (pese) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve
- në akset rrugore kryesore sipas tabelës nr 3 të ketë të paktën 5 (pesë) stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve

Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice sipas tabelës me poshtme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Tiranë Qendër (Unaza e Vogël)		
2	Përgjatë Rrugës së Kavajës		
3	Përgjatë Rrugës së Durrësit		
4	Përgjatë rrugës “Dritan Hoxha”		
5	*Etj.....		

Tabela nr. 2 orientuese:

Nr	Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja(adresa)	Person kontakti
1	Tiranë		
2	Kukës		
3	Fier		
4	Etj...		

Tabela nr.3 orientuese

Nr	Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja(adresa)	Person kontakti
1	Tiranë-Durrës		
2	Durrës-Fier		
3	Tiranë-Kukës		
4	Etj		

*Etj- Nënkupton të gjitha stacionet te shitjes se karburanteve me pakicë të tjera të cilat operatori ekonomik i disponon (në pronësi ose me qera).

*Shenim 3.1:

Ne zbatim te Kodit Civil operatoret ekonomik te disponojne stacione te shitjes se karburanteve me pakice si me poshte:

- Ne pronesi dhe/ose te jene te pasqyruara ne ekstraktin e rregjistrimit tregtar leshuar nga QKB;
- Kontrate noteriale qeraje ose furnizimi;

*Shenim 3.2:

Për të gjitha stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve duhet te paraqitet dokumentacioni si me poshte:

- Licencë leshuar nga pushteti vendor per tregtim karburantesh me pakice;
- Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK)
- Certifikate e mbrojtjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, të ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë.

Në këtë procedurë prokurimi marrin pjesë disa autoritete kontraktore si p.sh Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve , Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, etj,që ushtrojnë aktivitetin e tyre jo vetëm në Tiranë por në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në vendosjen e një numri minimal prej 3 stacionesh tregtimi me pakice te karburanteve në Bashkine e Tiranës është marrë parasysh madhësia e territorit të kësaj bashkie, si bashkia më e madhe në vend dhe numri i autoriteteve që e kane seline dhe operojnë kryesisht në kete bashki.

Në vendosjen e një numri minimal prej 5 stacionesh tregtimi me pakice te karburanteve në akset kryesore ndërlihdhëse të vendit dhe minimalisht 5 të tilla në bashkitë/njësitë administrative është marrë parasysh mbulimi me shërbim të ofrimit të karburantit me efijencë dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, qe jane pjese e kesaj procedure, duke patur parasysh shtrirjen e tyre gjeografike dhe territorin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Gjithashtu sjellim në vemendje se pothuajse të gjitha autoritetet pjesemarrese ne tender e ushtrojne veprimtarine e tyre edhe jashte bashkive ku kane selite perkatese, duke sjelle nevojën e pashmangshme per akses ne furnizim ne akset kryesore te vendit.

Per sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përpjestim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

Dokumentacioni për stacionet e tregtimit me pakice të karburanteve është kërkuar sipas parashikimit të pikes II “*Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga kon-sumatorët fundorë*” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 “Për percaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, i ndryshuar me ane të se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale si dhe dokumentacionin shoqërues, për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në kushtet kur kemi të bëjmë me furnizim me kartë, sipas kërkesës së disa Autoriteteve Kontraktore (referuar shtojcës 7 për lotin 1 “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”).

2.3.3 Flete analiza të lëshuar nga ISHTI për ato zëra të cilat është i akredituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave sipas standarteve në fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të së cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshem.

2.3.4Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesise përgjatë vitit 2024.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me anë të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete përgjatë vitit 2024.

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si mëposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin pranë stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike të personalizuar me targonë e cdo automjeti të autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsipër furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet të mbulojë furnizimin nepermjet kartave elektronike të personalizuar, sipas adresave të kërkuara nga Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar në VKM Nr 561 date 29.07.2016 “**Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njesite e qeverisjes së pergjithshem**“, Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojnë një faqe menaxhimi të karburanteve (web page),

ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepermjet kartës elektronike.

- Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit te sasisë se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit, si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet te ofroje edhe mundesine e afishimit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofroje edhe sherbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit kontraktor, sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet per te eliminuar levizjen e mundshme te targave nga mjetit shteteror drejt mjeteve private, si dhe sherbimin e dergimit te fotografive me ane te emailit per cdo furnizim te kryer te mjetit prane stacionit te shitjes se karburanteve me pakice me qellim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj .
- Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara me siper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarres perben kusht per s'kualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me ane te se cilit operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci per AK se furnizimi do te realizohet me karta elektronike sipas kerkesave te parashikuara me lart.

Shtojca 7

Loti 2 “Furnizim me lëndë djegëse për automjete benzine pa plumb”

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas Shtojcës 8.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiros vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”*.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të 3(tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 43, pika 4 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Në mënyrë që të mbulohet shërbimi i ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e karburanteve në pronësi ose me qera ku minimumi duhet të ketë stacion të tregtimit me pakice të karburanteve:

- Në bashkinë Tiranë të ketë të paktën 3 (tre) stacione të tregtimit me pakice të karburanteve sipas Tabelës nr.1;
- Në bashkitë/njësitë administrative sipas tabelës nr 2 të ketë të paktën në 5(pesë) stacion të tregtimit me pakicë të karburanteve
- Në akset rrugore kryesore sipas tabelës nr 3 të ketë të paktën 5 (pesë)stacione të tregtimit me pakicë të karburanteve

Operatori ekonomik duhet të paraqesë listen e detajuar të stacioneve të shitjes së karburanteve me pakice sipas tabelës me poshteme me të dhënat përkatëse:

Tabela nr. 1 orientuese:

Nr	Bashkia Tiranë	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Tiranë Qëndër (Unaza e Vogël)		
2	Përgjatë Rrugës së Elbasanit		
3	Përgjatë Rrugës së Kavajës		

4	Përgjatë Rrugës së Durrësit		
5	Përgjatë Rrugës së Dibres		
6	Etj.....		

Tabela nr. 2 orientuese:

Nr	Bashkia/Njesia Administrative	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Kukës		
2	Fier		
3	Etj...		

Tabela nr. 3 orientuese:

Nr	Aksi kombëtar	Vendodhja (adresa)	Person kontakti
1	Tiranë-Durrës		
2	Tiranë-Kukes		
3	Tiranë-Fier		
4	Etj.....		

**Etj-* Nënkupton të gjitha stacionet te shitjes se karburanteve me pakicë të tjera të cilat operatori ekonomik i disponon (në pronësi ose me qera)

Shenim 3.1:

Ne zbatim te Kodit Civil operatorët ekonomik te disponojne stacione te shitjes se karburanteve me pakice si me poshte:

- Ne pronesi dhe/ose te jene te pasqyruara ne ekstraktin e rregjistrimit tregtar leshuar nga QKB;
- Kontrate noteriale qeraje ose furnizimi;

Shenim 3.2:

Për të gjitha stacionet e tregtimit me pakice te karburanteve duhet te paraqitet dokumentacioni si me poshte:

- Licence leshuar nga pushteti vendor per tregtim karburantesh me pakice;
- Leje mjedisore perkatese leshuar nga QKL;
- Vertetim teknik leshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK);
- Certifikate e mbrotjes nga zjarri nga M.Z.SH;
- Police sigurimi ne nje nga shoqerite e sigurimeve qe operojne ne Shqiperi, te cilat duhet te jene brenda afatit te vlefshmerise daten e hapjes se ofertave;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM Nr. 970, datë

02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, të ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe itineraret ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë.

Në këtë procedurë prokurimi marrin pjesë disa autoritete kontraktore, ku njëri prej tyre është Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve , që ushtron aktivitetin e saj jo vetëm në Tiranë por në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe numri minimal prej 3 stacionesh tregtimi me pakice të karburanteve në Bashkinë e Tiranës është vendosur duke marrë parasysh madhësinë e territorit të kësaj bashkie, si bashkia më e madhe në vend si dhe nevojën që ka ministria si një institucion me shumë mjete dhe kërkesa të larta për akses në pika karburanti.

Në vendosjen e një numri minimal prej 5 stacionesh tregtimi me pakice të karburanteve në akset kryesore ndërlidhëse të vendit dhe minimalisht 5 të tilla në territorin e bashkive/njësiteve administrative është marrë parasysh mbulimi me shërbim të ofrimit të karburantit me efikasitet dhe efektivitet pranë autoriteteve kontraktore, që janë pjesë e kësaj procedure, duke patur parasysh shtrirjen e tyre gjeografike dhe territorin ku ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Gjithashtu sjellim në vëmendje se pothuajse të gjitha autoritetet pjesëmarrëse në tender e ushtrojnë veprimtarinë e tyre edhe jashtë bashkive ku kanë selite perkatese, duke sjelle nevojën e pashmangshme për akses në furnizim në akset kryesore të vendit.

Për sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

Dokumentacioni për stacionet e tregimit me pakice të karburanteve është kërkuar sipas parashikimit të pikës II “Procedura për dhënien e licencave për tregëtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëng-shëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga kon-sumatorët fundorë” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nenprodukteve të saj”, i ndryshuar me anë të se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale si dhe dokumentacionin shoqëruar, për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, në kushtet kur kemi të bëjmë me furnizim me kartë, sipas kërkesës së disa Autoriteteve Kontraktore (referuar shtojcës 7 për lotin 2 ”Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”).

2.3.3Flete analiza të lëshuar nga ISHTI për ato zëra të cilat është i akredituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave sipas stadarteve në fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të së cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshem.

2.3.4 Subjekti ofertues duhet të paraqese nje vertetim te leshuar nga ISHTI, qe vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve te legjislacionit Shqiptar dhe nuk ka patur penalitete per shkelje te cilesise pergjate vitit 2024.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar me anë të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete pergjate vitit 2024.

2.3.5 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si meposhte:

- Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin prane stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë me kartë elektronike te personalizuar me targon e cdo automjeti te autoritetit kontraktor, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.
- Subjekti duhet të deklarojë se merr përsiper furnizimin me karburant detyrimisht me pistoletë publike.
- Operatori ekonomik duhet te mbuloje furnizimin nepermjet kartëve elektronike te personalizuar, sipas adresave te kerkuara nga Autoritetit Kontraktor.
- Bazuar ne VKM Nr 561 date 29.07.2016 “**Per Standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve te karburantit ne njesite e qeverisjes se pergjithshem**“, Operoret ekonomik pjesemarres duhet te ofrojne nje faqe menaxhimi te karburanteve (webpage), ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit per mjetet efektive te transportit te kryhet nepermjet kartës elektronike.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve (webpage) duhet të ofrojë shërbimin e ngarkimit te sasisë se karburantit nga Operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qellim qe rimbushja e kartave elektronike te personalizuar me targon e mjetit, si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet AK. Nderfaqja duhet te ofroje edhe mundesine e afishimit si dhe administrimi i sasise se karburanteve te kryhet nga vet Autoriteti kontraktor.
- Faqja e menaxhimit te karburanteve duhet te ofroje edhe sherbimin per krijimin e struktures piramidale ne perputhje me strukturen piramidale te Autoritetit kontraktor, sherbimin e furnizimit me karburant nepermjet kartave elektronike në formën e stikerave (pullave), te cilat ngjiten ne xhamin e automjetit dhe ofrojne sherbimin e furnizimit me karburant vetem per ate automjet per te eliminuar levizjen e mundshme te targave nga mjetit shteteror drejt mjeteve private, si dhe sherbimin e dergimit te fotografive me ane te emailit per cdo furnizim te kryer te mjetit prane stacionit te shitjes se karburanteve me pakice me qellim identifikimin e mjetit dhe perdoruesit te saj .
- Mos ofrimi i sherbimeve te kerkuara mesiper ne menyre elektronike nepermjet Faqes se menaxhimit te karburanteve (webpage), qe ofron cdo operator ekonomik pjesemarres perben kusht per skualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me ane te se cilit operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci per AK se furnizimi do te realizohet me karta elektronike sipas kerkesave te parashikuara me lart.

Shtojca 7

Loti 3 “Lëndë djegëse për automjete, për përdorim shtëpiak dhe industrial GLN”

FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë "Tregtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve, përfshirë ato bio, si dhe lëndët djegëse", për lëndën djegëse gaz i lëngshëm të naftës (GLN), me kodin VIII. I-A, kategoria III/Ç (Lënde djegëse për përdorim termik civil dhe/ose industrial), të vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 2 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 ”Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencën profesionale për furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, ne kushtet kur kemi të bëjmë me furnizim me bot dhe me bombola sipas kërkesës së Autoriteteve Kontraktore Perfituese .

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet.Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve

financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2, të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për të zbatuar me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK.

Për sa i takon përcaktimit të vlerës së kërkuar ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit që prokurohet, është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”*.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të bilanceve të 3(tre) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore që tregojnë raporte ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit..

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 3, të ligjit me nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në nenin 43, pika 4 të VKM me nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në pikën 5 të nenit 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të këtij loti. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat

tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit, për realizimin e kontratës me sukses. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore etj, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2Flete analiza të lëshuar nga ISHTI për ato zëra të cilat është i akredituar, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hapjes së ofertave sipas standarteve në fuqi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, me anë të së cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike brenda një afati të arsyeshëm.

2.3.3Subjekti ofertues duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që vërteton se subjekti ofertues ka tregtuar karburante sipas standarteve të legjislacionit shqiptar dhe nuk ka patur penalitete për shkelje të cilesive përgjatë vitit 2024.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe nenit 40, pika 7, gërma c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar me anë të cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se e ushtrojnë aktivitetin e tyre në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor duke mos patur penalitete përgjatë vitit 2024.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Vërtetim teknik të lëshuar nga Organet e Miratuara të Vlerësimit të Konformitetit (OMVK), Leje mjedisore të tipit B, të lëshuar nga QKL, Akt-Teknik të lëshuar nga PMNZH, dhe Police Sigurimi të lëshuar nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për depozitat e tregtimit që vërteton kapacitetet depozituese minimalisht 500 m³ lidhur me rezervat e operatorit ekonomik, për të garantuar vazhdimësinë e furnizimit, sipas kërkesave të autoritetit kontraktore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, në zbatim të ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999 ”Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitete teknike me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses dhe për të garantuar vazhdimësi në furnizim, sipas kërkesave të autoritetit kontraktor.

Dokumentacioni i sipërpermendur është kërkuar sipas parashikimit të pikes III “*Kushtet për pajisjen me licencë të tregëtimit me shumicë të naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*” të VKM Nr. 970, datë 02.12.2015 ”Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregëtimin e naftës dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, me ane të se cilit operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë dokumentacionin përkatës dhe kapacitetin minimal të depozitave prej 500 m³, kapaciteti i cili është kusht për pajisjen me licence tregëtimi nga autoritetet kompetente shtetërore, për kategorinë V B,

Për sa me lart, AK gjykon se kërkesa e mësipërme është plotësisht e argumentuar, në përputhje dhe në përputhje me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit duke garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe duke mos ngushtuar apo kufizuar konkurrencën.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të disponojë të paktën 1 (një) autobot/ autocisternë me kapacitet mbajtës minimalisht 1 000 litra, të cilin mund ta ketë në pronësi ose me qira.

Për sa me sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë përkatëse sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtës	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim
2				Pronesi/qira/perdorim

Shënim:

Për mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje të disponohet kontrata noteriale përkatëse me qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, çertifikatën për transportin e lendeve të rrezikshme (ADR) dhe pashaportën e mjetit për kapacitetin mbajtës në litra.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, *me anë të* se cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Konkretisht, shërbimi i furnizimit me bot është kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe disponimi i nje mjeti te tille me kapacitet minimal prej 5000 litrash eshte plotesisht i argumentuar dhe ne proporcion me natyren e kontrates.

2.3.6 Subjekti ofertues duhet të zoterojë jo me pak se 1 automjet i cili duhet të jetë i hapur dhe i mbuluar me tendë kundër diellit, gjatë transportit, bombolat duhet të jenë të vendosura në kafaze mbrojtëse dhe të lidhen me rripa sigurimi, me qëllim shmangien e përplasjes me njëra-tjetrën.

Per sa me siper operatori ekonomik te paraqesë nje deklarate perkatese sipas formatit te meposhtem:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtes	Statusi
1				Pronesi/qira/perdorim
2				Pronesi/qira/perdorim

Shënim:

Per mjetet me status perdorimi qira/hua perdorje te disponohet kontrata noteriale perkatese mes qiradhenesit dhe qiramarresit.

Për këtë mjet duhet të paraqesi librezë qarkullimi, akt kolaudimi, sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, çertifikaten per transportin e lendeve te rrezikshme (ADR) dhe foto të automjetit ku të jenë të dukshme të dhënat teknike të kërkuara në këtë kriter

Ky kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rast se OE kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenit 40, pika 5, gërma ç) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, *me anë të* se cilit kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Gjithashtu ne zbatim të VKM Nr. 212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)” e vertetuar me nje nga format e disponimit sipas Kodit Civil, ose te jene te pasqyruara ne ekstraktin e QKR, etj.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë edhe deklaratat, nëpërmjet të cilave të deklarojë se:

- ✓ Furnizimin me lëndë djegëse me autobotin/ autocisternën e tij dhe shpenzimet e tij deri ne vendin ku ndodhen depozitat e autoritetit kontraktor perfitues duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore për transportin e lëndëve djegëse.
- ✓ Furnizimin me lëndë djegëse me anë të bombulave me automjetin dhe shpenzimet e tij deri ne adresat e e përcaktuara nga autoriteti kontraktor perfitues duke zbatuar të gjitha dispozitat ligjore për transportin e lëndëve djegëse.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, te ndryshuar dhe nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, te ndryshuar, me ane te se cilit operatori ekonomik vetedeklaron duke ofruar garanci per AK se furnizimi do te realizohet me autobot/ autocistern dhe me bombola sipas kerkesave te parashikuara në shtojën 7 të DST.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga Autoritetet Kontraktore referuar katalogut te standarteve “Blerje karburanti, me perjashtim te vajgurit, Jet A1 dhe karburantit që prokurohet nga fermerët”, bashkëlidhur procedurës së prokurimit.

Standartet e paraqitura në katalogun e sipercituar jane standarte te blera nga ana e Organit Qendror Bleres prej Drejtorisë së Përgjithshme te Standardizimit (DPS) si Organi Kombetar i Standardizimit ne Republikën e Shqipërisë. Nga komunikimi shkresor qe kemi patur me DPS-ne , ka sqaruar se ka detyrimin te adoptoje si standarte shqiptare (SSH) standartet europiane ne menyre identike dhe pa ndryshime ne tekstin origjinal. Si rrjedhim, referencat e normativave ne permbajtje te standartit jane pjese e tekstit origjinal te standarte te huaja dhe per kete arsye nuk ka te drejte te beje ndryshime.

Per sa me lart, duke qene se Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit nuk ka te drejte te beje ndryshime ne brendesi te standarteve qe shet, as Organi Qendror Bleres ne rolin e bleresit nuk ka te drejte te beje ndryshime.

Ne keto kushte sqarojme se per cdo standart te permendur ne brendesi te cdo standarti kryesor lejohet paraqitja e ekuivalentit te tij, qofte ai dhe Standarti Shqiptar (SSH).

NJËSIA E PROKURIMIT